
**STATUTI
I SHOQERISE PRIVATE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“EL SALM FOR CONTRACTING” SHPK**

PL

**STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“EL SALM FOR CONTRACTING” SHPK**

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**EL SALM FOR CONTRACTING**” Sh.p.k, që këtu e më poshtë do të quhet “Shoqëria”, nga ortaku:

SALEM YAHYA SALEM ALY SHEHABEDIN, atesia **YAHYA**, shtetas EGIPTIAN lindur me 13/07/1994 ne MONOFIYA, identifikohet nepermjet pasaportes Nr.A25561809

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë Statut të shoqërisë “**EL SALM FOR CONTRACTING**” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

**KAPITULLII
EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE,
SELIA, TERRITORI**

**NENI 1
FORMA DHE EMRI**

1.1 Shoqëria ka formën e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me iniciale Sh.P.K., të cilat vijnë përparrë ose menjëherë pas emrit të shoqërisë. Kjo shoqëri i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë.

1.2 Emri i shoqërise është “**EL SALM FOR CONTRACTING**” Shpk

1.3 Forma dhe emri i shoqërise mund të ndryshohen me vendim të Asamblee së Pergjithshme të Ortakeve.

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, në përputhje me legjislacionin shqiptare në përgjithsi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet ndërkombetare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

**NENI 3
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga “GLAUKIA” Lagja 17,Brenda

Ambienteve te Tregut Industrial, Durres, Shqiperi.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4 TERRITORI

4.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj lirisht si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërise.

4.2 Shoqëria mund të krijojë zyra ose përfaqësi të saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërise. Zyrat, filialat ose përfaqesite e shoqërise jashtë territorit të Republikës së Shqipërise do të zhvillojnë veprimtarine e tyre në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatese.

KAPITULLI II OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria “**ELSALM FOR CONSTRUCTING**” Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie të konsulences dhe sherbimeve ndaj shoqerive ne Republiken e Shqiperise dhe ne territoret e tjera dhe ka si objekt të veprimtarise së saj:

5.1 PUNIME TE NDRYSHME NE FUSHEN E NDERTIMIT.

Me qëllim arritjen e objektit të saj, shoqëria me vendim të organit kompetent, mund të zotëroje në mënyre të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të aktiviteteve te ndryshme. Pjesmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojne përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakeve.

NENI 6 KOHEZGJATJA

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të papërcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likujdimi me vendim të Asamblese së Ortakeve, si dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj.

KAPITULLI III
KONFIDENCIALITETI,
DOKUMENTET E DISTINUARA PER TE TRETET

NENI 7
KONFIDENCIALITETI

Ortakët e shoqërise si dhe personat e tjere të pranuar në shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojne asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhe, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

NENI 8
DOKUMENTET E DESTINUARA PER TE TRETET

Të gjithë aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojne lexueshem emrin e shoqërise dhe pas tij fjalet "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "Sh.P.K.", si dhe emrin e administratorit ose te administratorëve.

KAPITULLI IV
KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET,
PJESET DHE TRASFERIMI I TYRE

NENI 9
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 LEKE (Njeqind mijë Leke), i ndare në 1 pjese. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

1- SALEM YAHYA SALEM ALY SHEHABEDIN	100,00 %
-------------------------------------	----------

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne një llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 10
TE DREJTAT E ORTAKEVE NE LIDHJE ME KAPITALIN

10.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërise kryhet sipas vendimit të asamblese së përgjithshme të ortakeve, me shumicën e $\frac{3}{4}$ (tre të katërtave) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise.

10.2 Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar, i perket ortakeve e drejta me opcion mbi kapitalin ne zmadhim, ne proporcione kuoten e kapitalit qe kane ne pronesi. Nese ndonjeri nga ortaket nuk do te nenshkruaj kuoten e tij te kapitalit ne zmadhim, e drejta e opcionit do ti perkase ortakeve te tjere.

Duke mos e ushtruar ortakët të drejtën e opcionit, kapitali në zmadhim i panënskruar do te nënshkruhet nga pale të treta.

10.3 Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e shoqërise shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e saj themeltar.

10.4 Kuotat e kapitalit të shoqërise nuk mund të rendohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale. Në rast shitje të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise për efekt zbatimi të një vendimi gjyqësor apo përbushje të një detyrimi, enti që ekzekuton vendimin ose detyrimin (zyra përmbarimore ose ndonjë organ tjetër kompetent), duhet të ketë në konsiderate respektimin e kërkesave të nenit 13 të këtij statuti. Secili ortak që rëndon me barrë apo të drejta të tjera reale kuotat e tij, ka detyrimin ti shpjegoje nen 13 të këtij statuti subjektit në favor të cilit vendoset barra siguruese.

10.5 Secili ortak ushtron të drejtat pasurore të parashikuara nga ligji në proporcion me kuotat e pjesemarrjes ne kapital.

10.6 Ortakët që nuk marrin pjesë në administrimin e shoqërise kanë të drejtë t'i kërkojnë organit administrativ informacione mbi aktivitetin e shoqërise, si dhe të konsultojnë dokumentet kontabel e dokumentet e tjera që lidhen me administrimin e saj.

NENI 11 FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKUT

Fusha e autoritetit të ortakëve, përqindja e fitimeve ose humbjeve do te kene si kriter bazë kontributin e çdo ortaku në kapitalin e shoqërise, si dhe kompetencat që gezon ortaku në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuar në këtë statut.

NENI 12 FINANCIMI I SHOQERISE

12.1 Organi administrativ, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të kërkoje nga ortakët fondet e nevojshme për arritjen e objektit të shoqërise.

12.2 Financimet e mëtejshme të ortakëve do të jene me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpermjet të cilit jepen këto fonde.

NENI 13 TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

13.1 Kapitali themeltar i shoqërise ose pjesë të tij mund të trasferohen lirisht mes ortakeve të shoqërise. Kapitali themeltar i shoqërise ose pjesë të tij mund të trasferohen tek persona të tretë vetëm pasi ortakët e shoqërise në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar zyrtarisht kanë refuzuar ushtrimin e të drejtës së parablerjes.

13.2 Trasferimi i kapitalit themeltar të shoqërise ose i pjeseve te tij tek persona të tretë behet vetëm në këtë mënyre:

- Oferta per shitje u drejtohet te gjithe ortakeve me shkrim;
- Oferta duhet te percaktoje numrin e kuotave qe shiten dhe çmimin e tyre;

Nese ortaket e shoqerise brenda 3 (tre) muaj nga oferta me shkrim nuk pranojne blerjen e kuotave te ofruara me çmimin e percaktuar, atehere konsiderohet se ata lejojne shitblerjen tek te tretet.

13.3 Kapitali themeltar eshte lirisht i trashegueshem ne rruge trashigimie. Bashkshorti, paraardhesit dhe pasardhesit mund te behen ortake nepermjet trasferimit te pjeseve te kapitalit themeltar sipas kushteve qe lejohen ne ligj.

13.4 Trasferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt notarial dhe te depozitohen ne organin kompetent.

13.5 Klauzolë miratimi. Nese asnje ortak nuk do te ushtrojë te drejtën e parablerjes ne kohe dhe sipas kushteve të parashikuar për transferimin e kuotave apo të drejten e opcionit, kalimi i kuotave nuk do te mund te bëhet pa pëlqimin e Asamblese se Ortakeve që vendos për pranimin e trasferimit te nje person i tretë. Ortaket mblidhen jo më herët se 30 (tridhjetë) ditë, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) dite, nëpermjet Asamblese të Zakonshme të Ortakeve, duke vendosur me votën pro (ne favor) me të paktën gjysmen e kapitalit themeltar.

13.6 Pelqimi mund te refuzohet vetem kur bleresi nuk jep garanci te mjaftueshme rreth kapaciteteve financiare ose për kushtet objektive o për aktivitetin që kryen, të tilla që hyrja e tij në shoqëri mund te jenë e dëmshme për arritjen e objektivave nga shoqeria ose konflikt me interesat e shoqërisë apo te ortakevete te tjera. Asambleja e Ortakeve duhet te njoftojë me shkrim në adresën që rezulton vendimin për miratim.

Nese brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës për miratim ortaku kërkues qe nuk ka marrë asnje komunikim miratimi do te konsiderohet si i dhene dhe ortaket mund te transferojne kuoten e tyre.

13.7 Nese miratimi i mohohet do te prezantohet një tjetër blerës. Për këtë qëllim, Asambleja e Ortakeve duhet te tregojë në letrën e refuzimit emrin e blerësit të propozuar; transferimi duhet te plotësohet me të njëjtat kushte të përcaktuara në kërkesën për miratim nga ana e aplikantit brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve pas marrjes së komunikimit të fundit.

Përndryshe, ortaku do te jetë i lire për të shitur pjesëmarrjen e tij personit që konsideron me te përshtatshem.

KAPITULLI V **ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

PL

NENI 14 **ORGANET DREJTUESE**

14.1 Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Ortakëve dhe Administratori. Për efekt të ndryshimeve që mund të pësoje shoqëria në të ardhmen dhe shtimit të numrit të ortakëve, këtu e në vazhdim organit zotërues të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise do ti referohemi me termin Asamble e Ortakëve.

14.2 Shoqëria mund të emeroje më shume se një Administrator. Ne çdo rast, kur termi "Administrator" perdoret për te percaktuar Administratorin e shoqerise "**EL SALM FOR CONTRACTING**" Sh.p.k., ky term nenkupton te gjithe Administratoret e saj sado qofshin keta ne numer.

14.3 Perveç organeve te parashikuara me siper Asambleja e Ortakeve mund te krijoje edhe organe te tjera drejtuese, ne aktet e krijimit te ketyre organeve do te percaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre.

14.4 Administrator i shoqerise per një periudhe 5 (pese) vjeçare është emeruar ENXHI ALI.

KAPITULLI VI **ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

NENI 15 **VENDIMET E ASAMBLESE TE ORTAKEVE**

15.1 Asambleja e Ortakeve vendos per çeshtjet qe ligji apo ky statut i rezervon ketij organi, si dhe per çeshtjet per te cilat, organi administrativ kerkon mendimin apo miratimin e ortakeve.

15.2 Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne një shumice te zakonshme, Asamblea e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjesë ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 50 % te kuotave te kapitalit themeltar.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, sipas ligjit mbi shoqerite tregtare, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se 75 % te numrit total te kuotave te kapitalit themeltar jane te pranishem dhe vendosin me voten e $\frac{3}{4}$ (tre te katertave).

NENI 16 **KONSULTIMI ME SHKRIM I ORTAKEVE**

16.1 Ne perputhje me dispozitat e statutit, vendimet e ortakeve mund te merren pas një konsultimi me shkrim qe organi administrativ i drejton secilit prej tyre. Ne kete rast, organi administrativ i komunikon ortakeve tekstin e projekt-vendimit qe do te merret

dhe i kerkon te shprehin vullnetin e tyre ne lidhje me kete çeshtje.

16.2 Vendimet e marra ne kete menyre jane te vlefshme kur vendimi merret nga shumica qe ligji apo ky statut kerkon per ate çeshtje.

NENI 17

MENYRA DHE VENDI I THIRRJES I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

17.1 Asambeja e Ortakeve thirret prane selise se shoqerise, apo ne ndonje vend tjeter brenda Republikes se Shqiperise, nepermjet nje njoftimi me shkrim edhe nepermjet postes elektronike (E-mail), duke e konfirmuar marrjen, qe iu dergohet ortakeve nga Kryetari i Asamblese se Ortakeve dhe / ose Organi Administrativ.

17.2 Njoftimi i thirrjes se mbledhjes se asamblese duhet te kryhet 15 (pesembedhjete) dite perpara dates se mbledhjes dhe duhet te percaktoje shprehimisht daten, oren, vendin si dhe rendin e dites. Ne rast pamundesie apo mosveprimi nga ana e organit administrativ, mbledhja e asamblese se ortakeve mund te thirret nga esperti kontabel i autorizuar, nese ka te tille, ose nga nje apo me shume ortake, te cilet perfaqesojne jo me pak se 10% te kapitalit te shoqerise.

NENI 18

KRYETARI I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

18.1 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve emeron Kryetarin e Asamblese.

18.2 Kryetari i Asamblese verifikon thirrjen dhe mbledhjen e rregullt te Asamblese se Ortakeve, verteton identitetin apo legitimimin e perfaqesuesit te ortakeve dhe drejton zhvillimin e rregullt te mbledhjes.



20.3 Kompetencat e Asamblese se Jashet e Kosovës te Ortakeve janë:

- * Vendos ne lidhje me madhunin e zvogëluar e kapitalit themelor te shoqerise;
- * Vendos ne lidhje me cheqizatjen e shoqerise si dhe per mbarimin e jasudimit e saj;
- * Vendos per ndryshimin e emrit te shoqerise;

NENI 19 **PJESEMARRJA NE VENDIME**

Çdo ortak ka te drejten e nje vote per çdo kuote te kapitalit themeltar te shoqerise qe ai zoteron. Nje ortak mund te perfaquesohet ne mbledhjen e asamblese nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete, nepermjet nje akti perfaqesimi me shkrim.

NENI 20 **KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE**

20.1 Asambleja e Ortakeve mund te jete e zakonshme dhe e jashtezakonshme, kjo ne varesi te çeshtjes per te cilin eshte thirrur. Vendimet e Asamblese se Zakonshme te Ortakeve merren me shumice te thjeshte te votave te ortakeve. Vendimet e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve merren me nje shumice te cilesuar prej $\frac{3}{4}$ (tre te katertave) te votave te ortakeve te shoqerise. Per çfare nuk eshte pasqyruar ne kete nene, Asambleja e Ortakeve te shoqerise vendos ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14. 04. 2008.

20.2 Kompetencat e Asamblese se Zakonshme te Ortakeve do te jene:

- Vendos per perpilimin ose miratimin e rregulloreve per shoqerine apo per fusha te veçanta te veprimtarise.
- Vendos per ndryshimin e selise se shoqerise.
- Vendos per krijimin e zyrave ose te perfaqesive si dhe per krijimin e shoqerive ose te ortakerive me persona te tjere fizike apo juridike.
- Vendos per politiken afariste te shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saj.
- Emeron dhe shkarkon Administratorin e shoqerise, ekspertin kontabel, likujdatori duke percaktuar dhe detajuar kompetencat e tyre, te drejtat, detyrimet, kohezgjatjen ne detyre, dhe shperblimin e tyre.
- Vendos ne lidhje me krijimin e organeve te tjera drejtuese qe mund t'i nevojiten shoqerise duke percaktuar ne aktet e krijimit te ketyre organeve, kohezgjatjen dhe kompetencat e tyre, per emerimin e personave drejtues te ketyre organeve.
- Asambleja e Ortakeve marrjen e vendimeve e kryen vete dhe nuk ben delegimin e vendimarrjes te asnjë organ tjeter. Asambleja e Ortakeve vendos edhe ne lidhje me krijimin e sektoreve te veçante te veprimtarise se shoqerise.
- Shqyrton dhe miraton bilancin vjetor.
- Miraton tarifat e sherbimeve te shoqerise.
- Miraton pagat e te punesarve ne shoqeri.

20.3 Kompetencat e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve jane:

- Vendos ne lidhje me zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
- Vendos ne lidhje me kohezgjatjen e shoqerise si dhe per mbarimin e likujdimin e saj.
- Vendos per ndryshimin e emrit te shoqerise.



- Vendos ne lidhje me ndryshimin e statutit te shoqerise.
- Vendos per ndryshimin e formes, per ndarjen e shoqerise si dhe per bashkimin e saj me shoqeri te tjera.
- Percakton llojin e fondeve te ndryshme dhe masen e tyre, percaktimin e dividentit, marrjen dhe dhenien e huave, kredive, borxheve.
- Realizon marredheniet me te rendesishme ekonomike dhe financiare te shoqerise me persona te tjere fizik apo juridik, vendas apo te huaj.
- Vendos ne lidhje me transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise.

20.4 Perveç kompetencave te lartpermendura, te cilat jane ekskluzive per te, Asambleja e Ortakeve ushtron çdo kompetence qe ia njeh ligji.

20.5 Asambleja e Ortakeve ne rastet kur nuk ka emeruar Administrator, kryen dhe kompetencat qe ne kete Statut jane percaktuar per kete te fundit. Gjithashtu Asambleja e Ortakeve mund te kufizoje Administratorin ne ushtrimin e kompetencave te tij.

NENI 21 ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ

21.1 Kompetencat e Administratorit ose te Administratoreve, te cilet mund edhe te mos jene ortake te shoqerise, ne menyre konkrete dhe te detaujar percaktohen ne aktin e tyre te emerimit. Veç te tjerave qe mund te detajohen ne kete akt, Administratori ka edhe keto kompetencia:

- Kujdeset per funksionimin e perditshem normal te shoqerise ose te nje pjese te aktivitetit ekonomik dhe financiar te saj, sipas percaktimit ne aktin e emerimit.
- Pergatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te shoqerise sipas legjisacionit ne fuqi dhe ia paraqet Asamblese se Ortakeve per shqyrtim.
- Koordinon veprimtarine e personave te punesuar ne shoqeri.
- Ndjek problemet e shoqerise ne marredhenie me organet shteterore ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.
- I propozon Asamblese se Ortakeve tarifat e sherbimeve dhe pagat per personelin e punesuar ne shoqeri.
- I propozon Asamblese se Ortakeve rregulloren e shoqerise.
- Administratoret kane te drejte te gjithe sebashku ose vecmas nga njeri tjetri te perfaqesojne shoqerine ne lidhje me te tretet.

21.2 Administratori ose Administratoret jane perjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit ose per faje te kryera gjate ushtrimit te administrimit te shoqerise. Pergjegjesia eshte individuale ose solidare, kjo ne varesi te rr Ethanave dhe te menyres se si eshte vepruar, pra individualisht ose solidarisht.



21.3 Administratori o Administratoret nuk jane perjegjes ndaj shoqerise ose te treteve per konfliktin e interesit qe mund te krijohet duke zhvilluar posicione te ndryshme ose te ngashme ne shoqeri dhe organizma te ndryshem.

KAPITULLI VII **KONTROLLI KONTABEL,** **BILANCI, DIVIDENTET**

NENI 22 **KONTROLLI KONTABEL**

Kontrolli i jashtem kontabel i shoqerise kryhet nga eksperte kontabel te autorizuar, sipas legjislacionit ne fuqi. Asambleja e Ortakeve do te emeroje nje apo me shume eksperte kontabel ne ato raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kerkohet ne baze te ligjit.

NENI 23 **BILANCI DHE REZERVAT**

23.1 Bilanci mbylljet ne 31 dhjetor te çdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiare dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar, i paraqiten per shqyrtim asamblese se ortakeve, e cila vendos mbi miratimin, ndryshimin ose rrezimin e ketyre akteve, kur e konsideron te nevojshme Asambleja e Ortakeve mund te beje rekomandimet e nevojshme ne lidhje me çeshtjen ne diskutim.

23.2 Me mbylljen e secilit vit financier, Administratori i vetem merr masat e nevojshme per hartimin e projekt-bilancit te aktivitetit per vitin financier te mbyllur, ne menyre qe Asambleja e Ortakeve te vendose mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme te tij brenda afateve te percaktuara nga ligji.

23.3 Asambleja e Ortakeve vendos mbi ndarjen ndermjet ortakeve te shumave qe rezultojne si fitime sipas bilancit te aprovuar rregullisht, pasi nga keto shuma te jene zbritur humbjet e mundshme te viteve te meparshme, si dhe te jene lene menjane shumat e nevojshme per krijimin e rezerves ligjore. Rezerva ligjore krijohet vit pas viti nepermjet lenies menjane te nje shume te barabarte me 5 % te fitimit neto te realizuar gjate secilit vit financier, deri sa te arrihet nje shume e barabarte me 10 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

23.4 Asambleja e Ortakeve ne çdo moment mund te vendose krijimin e rezervave te tjera, si dhe masen e tyre.

KAPITULLI VIII **MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE,**

LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

NENI 24 MBARIMI

Shoqeria mbaron me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve ose kur ka nje prishje te parakohshme per arsyet e parashikuara ne ligj.

NENI 25 LIKUJDIMI

25.1 Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi Asambleja e Ortakeve cakton nje ose disa likujdues, te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

25.2 Ne fund te procesit te likujdimit, Asambleja e Ortakeve vendos mbi bilancin perfundimtar finanziar dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit.

25.3 Mbas pagimit te kreditoreve Asambleja e Ortakeve mban pjesen e mbetur te kapitalit qe u shperndahet ortakeve.

NENI 26 LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

26.1 E drejta e largimit lejohet në rastet e parashikuara me ligj.

Njoftimi i largimit duhet ti dërgohen shoqërisë me shkrim dhe duhet të përfshijë emër mbiemer të ortakut që largohet, vendbanimin, për komunikimet e nevojshme mbi procedurën e largimit dhe numrin e kuotave në lidhje me të cilat synon të largohet motivimet përkatëse.

Ortakët që largohen nga shoqëria kanë të drejtë të marrin një rimbursim të kuotave në proporcion të kapitalit të shoqërise. Për këtë qëllim është përcaktuar duke marrë parasysh vlerën e tij të llogaritur në bazë të kapitalit neto.

26.2 Shlyerja e kuotave për të cilën është ushtruar e drejta e largimit duhet të bëhet brenda 90 (nentedhjete) ditëve nga komunikimi që i bëhet shoqërise. Ajo gjithashtu mund të bëhet me anë të blerjes nga ortakët e tjerë në proporcion me pjesëmarrjen e tyre ose nga një palë e tretë të identifikuar në mënyrë unanime nga ortakët.

Për këtë qëllim, administratorit i kërkohet që të njoftojë ortakët e tjerë mbi mbarëvajtjen e procedures se largimit të ortakut, dhe t'ia ofrojë për shitje, në emër dhe për llogari të ortakut që largohet, pjesën mbi të cilën është ushtruar largimi, duke deklaruar çmimin e kuotes dhe afatin për pagesën e saj, jo më shumë se 3 (tre) muaj. Për shitjen zbatohen rregulla mbi ushtrimin e së drejtës të parablerjes në këtë Statut.

26.3 Ortakët duhet të informojnë shoqërine për qëllimin e tyre për të blerë kuotat e ortakut që largohet ose emrin e palës së tretë blerëse brenda 30 (tridhjete) ditëve nga

marrja e komunikimit nga shoqeria dhe qëllimin e ortakut për t'u larguar. Nëse oferta është pranuar nga shumica e ortakëve, pjesa e ortakut që largohej do të ndahet në proporcion midis ortakeve ne baze te kuotave përkatëse që kanë në kapitalin themeltare.

Nëse kjo nuk ndodh, rimbursimi do të bëhet duke përdorur rezervat e disponueshme ose në mungesë përkatësisht zvogëlimin e kapitalit; nese nuk është e mundur një rimbursim i kuotave të ortakut që largohej, atehere shoqëria vendoset në likujdim.

26.4 Përjashtimi i ortakut mund të bëhet, në rast të vonesës apo pamundësisë së kryerjes të punës ose shërbimeve që mund të kryhen nga një ortakë.

Përjashtimi duhet të përcaktohet me vendim të Asamblese së Pergjithshme të Ortakëve me tre të katërtat e votave.

Pas zbulimit të vendimit për të përjashtuar ortakun, ky i fundit është i penguar për të ushtruar të drejtat shoqërore.

26.5 Për likujdimin e kuotës të ortakut që largohej, aplikohet procedura e rimbursimit e parashikuar për largimin, përjashtuar këtu mundësia e shlyerjes së kuotës nëpërmjet reduktimit të kapitalit themeltare dhe likujdimin e mundshëm të shoqërisë.

Përjashtimi mund të revokohet, derisa kuota e ortakut të përjashtuar nuk i është rimborsuar.

KAPITULLI IX **MOSMARREVESHJET DHE DISPOZITA TE FUNDIT**

NENI 27 **ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

Çdo mosmarreveshje a konflikt ne lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likujdimin e kesaj shoqerie, ortaket do te angazhohen se do ta zgjidhin me mirekuptim, dhe ne rast se kjo nuk arrihet kompetente per gjykimin e mosmarreveshjeve a konflikteve te mundshme do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 28 **DISPOZITA TE FUNDIT**

28.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me kete Statut dhe me ligjin shqiptare. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut, do te aplikohen dispozitat e legjisacionit shqiptare ne fushen e shoqerive tregtare si dhe legjisacioni shqiptare ne pergjithsi.

28.2 Shoqeria do te kete vulen, stemen, logon dhe faqen e internetit (website), format dhe madhesite do te percaktohen nga asambleja e ortakeve ne veçanti dhe me propozim te administratorit.



28.3 Ky Statut eshte hartuar ne 3 (tre) ekzemplare, duke patur secili ekzemplare fuqi te njejte ligjore.

Tirane, 03/12/2019

**ASAMBLEJA E ORTAKOVE TE SHOQERISE
“EL SALM FOR CONSTRUCTING” SH.P.K.**

SALEM YAHYA SALEM ALY SHEHABEDIN

